



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 7.10.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Salihe Mustafa, Slavko Simiq, Mexhide Mjaku-Topalli,
Etem Arifi, dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Lirije Kajtazi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Pajazit Krasniqi-RTK, Sead Bardhi-ZPRK-KKK, Ukë Gashi-ZPRK, Genc Jaha-KDI, Fjolla Uka-KDI, Blerta Bejtullahu- EUSR-EU Office, Besarta Jashari-praktikante, Teuta Hoxha-YIHRks dhe Selvete Gerxhaliu-GDNJD.

Mbledhjen e kryesoi, Salihe Mustafa, zëvendëskryetare parë e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër;
3. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës ;

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

1. Miratimi i Raportit për monitorimit e Ligjit për Personat e Verbër;

Salihe Mustafa i njoftoi anëtarët e Komisionit se Grupi i Punës ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër dhe me këtë rast ka pasur vizita dhe takime në terren, me ç'rast kanë marrë informatat rreth gjendjes në terren, ndërkohë që grupi punues ka përpiluar raportin me rekomandime.

Në vazhdim ajo kërkoi propozimet eventuale të anëtarëve të tjerë të komisionit, lidhur me plotësimin apo ndryshimin eventual në raportin e monitorimit.

Kujtim Paçaku duke falënderuar Grupin e Punës për monitorimin e ligjit, theksoi se do të jetë e rëndësishme të sigurojnë një listë, e cila do të pasqyrojë inkuadrimin e personave të verbër në institucione shtetërore, si dhe rreth trajnimeve të programit brail, se a do të jetë ky si propozim apo do të kalojë në procedura të tjera.

Mexhide Mjaku – Topalli lidhur me raportin e monitorimit, theksoi se ka bërë një propozim rreth tekstit të maturës që të bëhet edhe me shkrimin brail për nxënësit të cilët kanë problem me shikimin, por ajo informoi se nga informacionet që ka siguruar në Projektligjin për Maturën Shtetërore, që është duke u shqyrtuar në Komisionin për Arsim, do të jetë e përfshirë edhe kjo çështje.

Salihe Mustafa lidhur me këtë propozim theksoi se në raport të monitorimit do të bëhet propozimi për ndryshimin e ligjit për personat e verbër dhe atëherë do të mund ta marrin parasysh propozimin konkret nga parafolësja.

Lidhur me kërkesën e z. Paçaku, për informacionet rreth shifrës së personave të verbër të cilët janë të kyçur në institucionet shtetërore, ajo tha se nuk posedojnë statistika të tilla.

Kujtim Paçaku theksoi se si Komision do të jetë e dobishme të bëjnë presion në identifikimin e këtyre rasteve, në mënyrë që të ndikojnë në ngritjen e numrit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të punësuar në bazë të garancisë që e kërkon ligji.

Etem Arifi duke u ndërlidhur me procesin e monitorimit, tha se pas propozimit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit, do të merren parasysh rekomandimet e bëra nga Komisioni dhe në këtë mënyrë do të plotësohet apo do të sanohen defektet aktuale të këtij ligji.

Salihe Mustafa theksoi se duhet të diskutohet vetëm për përmbajtjen e raportit të monitorimit, për shqetësimet e tjera lidhur me këtë fushë, ajo tha se mund të ngritën shqetësimet e deputetëve në procedurat e punës në Kuvend.

Mexhide Mjaku tha se nga vizitat e bëra në terren, kanë identifikuar faktorë që kanë ndikuar në mungesën e personave të punësuar, të cilët janë me aftësi të kufizuara për shkak se në disa raste atyre ju ka munguar aftësimi profesional dhe për këtë shkak ka rezultuar me një numër të vogël të të punësuarve me aftësi të kufizuara.

Salihe Mustafa theksoi se institucionet kompetente për nxjerrjen e akteve nënligjore, duhet që deri në kohën e plotësimit dhe ndryshimit të ligjit për personat e verbër, t'i nxjerrin aktet nënligjore.

Pas këtyre diskutimeve, Komisioni njëzëri votoi për raportin e monitorimit të Ligjit për personat e verbër dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

I. I rekomandohet Kuvendit që të miratojë Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër, me rekomandimet e propozuara.

2. Të ndryshme.

Kujtim Paçaku tha se edhe pse e ka votuar raportin e monitorimit të ligjit, ai kërkon që të ftohet një person përgjegjës që ta informojë Komisionin për gjendjen e punësimit tek personat e verbër.

Po ashtu ai kërkoi informacione se kur do vazhdohet agjenda e vizitave nëpër komunat e Kosovës nëpër njësitin e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, sepse ato vizita që i kanë realizuar ishin shumë të suksesshme, është bërë një sensibilizim i mekanizmave dhe kur do të fillohet me vizitat nëpër komunat e tjera.

Salihe Mustafa- tha se së bashku do të vendosim se kë do ta ftojmë për të raportuar nga qeveria për punësimin e të verbërve, dhe ju si anëtarë të komisionit mund të bëni propozime dhe vendosim bashkërisht.

Sa i përket vizitave nëpër komuna, ajo tha se një plan i punës është dhe do të zbatohet ai plan i punës, por dihet se kryetarja e Komisionit është jashtë vendit, por me administratën e Komisionit merreni vesh dhe na njoftoni dhe ne jemi të gatshëm ti përgjigjemi ftesës suaj.

Mexhide Mjaku- Topalli tha se për vizitat nëpër njësitë Komunale të të drejtave të njeriut kam kontaktuar me administratën dhe kam kërkuar ti kemi raportet nga tereni, kur ishim në vizita, sepse na intereson se sa po punohet, si po respektohen të drejtat e njeriut, ku po shkelen ato, thjesht të kemi raport me statistika. Përveç Komunës së Ferizajt, nuk kemi raport, por është mirë si administratë të kërkonin raportin sepse kanë premtuar që ta sjellin raportin brenda 10 ditëve.

Kujtim Paçaku tha se kur të caktohen vizitat është mirë të jetë i pranishëm edhe kryetari i Komunës, apo së paku nënkryetari, përndryshe mos të caktohen takimet sepse është mirë të jetë edhe dikush nga njerëzit përgjegjës të politikës, që ti jepni seriozitet takimit pa anashkaluar njësitet nëpër komuna.

Salihe Mustafa tha se pajtohet që të jenë të pranishëm në takime kryetarët dhe po ashtu të jenë edhe raportet me shkrim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi